



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.270/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, për shkak të qëndrimit në oborrin e qendrës së votimit, gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.270/2017 e datës 12.06.2017, e Lëvizjes Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, lidhur me qëndrimin e Agim Ademaj ish-deputet(kandidat potencial për deputet) ne oborrin e qendrës se vendvotimit 0601c ne gjimnazin “Haxhi Zeka” në Istog.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se gjatë ditës së zgjedhjeve, me datën 11.06.2017 aktivistja nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje ne qendrën e votimit 0601c, në gjimnazin “Haxhi Zeka” në Istog, kandidat për deputet Agim Ademaj (ish-deputet i LDK-së), ka qëndruar në oborrin e qendrës së votimit .Për këtë ne kuptim dispozitës se nenit 213, te Kodit Penal të Republikës se Kosovës është bere cenimi i përcaktimit të lirisë të votuesit. Ankesës si dëshmi është bashkangjitur një fotografi e printuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografia, të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë te qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim te nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar pretendimet ankimore. Sepse nga fotografia e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se është kryer shkelja e pretenduar në ankesë, kjo dëshmohet

edhe nga deklarata e Komisionerit - menaxherit të qendrës së votimit 0601c, Ibrahim Bytyqi, i cili në dëshminë e deponuar me datën 13.06.2017 për PZAP-it, ka pohuar se nuk qëndrojnë pretendimet në ankesë për arsye se Agim Ademaj, në këtë qendër të votimit ka ardhur për te votuar dhe pas votimit i njëjti është larguar dhe nuk ka ndikuar ne procesin e votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
Anr.270 /2017 më datën 13.06.2017**



**Kryesuesi i Panelit:
Fejzullah Rexhepi**

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24)orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*